



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 3300/2 prot.

Tiranë, më 20.12.2021

**VENDIM**

Nr. 70 , datë 20 .12.2021

**PËR**

**“SHKARKIMIN E ADMINISTRATORIT TË UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË,  
TIRANË”**

Në zbatim të nenit 47, pikës g të nenit 49, të Ligjit Nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 49 dhe pikës r të nenit 51 të Statutit të UMT-së, mbështetur në shqyrtimin e veprimtarisë së Administratorit të UMT-së, z. Besnik Çina nëpërmjet gjithë komunikimit të Bordit të UMT-së, Rektorit dhe palëve të tjera të përfshira në procedura dhe vendimmarrje të lidhura me informacionin shkresor të Rektorit të UMT-së z. Arben Gjata, Bordi i Administrimit,

**VENDOSI:**

1. Për shkeljet e konstatuara të paraqitura në Relacionin, bashkëlidhur, Z. Besnik Çina të shkarkohet nga detyra e Administratorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë;
2. Të njoftohet z. Besnik Çina, për t’u nohur paraprakisht me pikën 1, parashikuar në këtë Vendim dhe të shprehet lidhur me këtë, ditën e enjte, datee 23.12.2021 ora 8:00 në mbledhjen e Bordit.
3. Ngarkohet Sektori i Koordinimit Institucional, për njoftimin e palëve të përfshira në procedurë.
4. Pika 2 dhe 3 e këtij Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**ZAMIRA GJINI**

**ZV. KRYETAR**

**MONIKA FIDA**

**ANËTAR**

**ANIS THODHORJANI**

**ANËTAR**

**VERA OSTRENI**

**ANËTAR**

**ALTINA XHAFERI**

**ANËTAR**

**ALBANA GJINOPULLI**

**ANËTAR**

**ENDRIT YZEIRAJ**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Tiranë, më 20.12.2021

RELACION

***“Mbi performancën dhe ligjshmërinë e veprimeve të Administratorit, bazuar mbi të gjithë dokumentacionin shkresor, të paraqitur në Bord”***

I mbajtur sot më datë **20.12.2021**, nga anëtarët e Bordit të Administrimit të UMT-së, *“Mbi performancën dhe ligjshmërinë e veprimeve të Administratorit, bazuar mbi të gjithë dokumentacionin shkresor, të paraqitur në Bord”*, të ngritura si problematika nga Rektori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, në shkresën me nr. 3105 prot., datë 26.11.2021 *“Memo mbi disa procedura të kryera nga administratori i UMT-së”*, shkresës me nr 2596/2 prot., datë 27.10.2021 nga Drejtoria e Shërbimeve Juridike dhe e Burimeve Njerëzore, Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivës, *“Informacion mbi procedurat e punësimit për periudhën...”* të shkresës me nr. 2913 prot., datë 10.11.2021 e znj. L.K. *“Mbi paligjshmërinë e Urdhërit nr. 184, datë 08.11.2021 të Administratorit të UMT-së”*, shkresës së Administratorit me nr. 2919/3 datë 19.11.2021 *“Kthim përgjigje...”*; shkresës me nr. 2919/5 e znj. L.K. datë 03.12.2021 *“Kthim përgjigje Administratorit”*.

Bordi i Administrimit, në mbledhjen e datës 01.12.2021 thërret Dekanin e FM-së, Administratorin e UMT-së, Drejtorin e Drejtorisë Juridike dhe Përgjegjësin e Sektorit të Burimeve Njerëzore në UMT, për t'i dëgjuar mbi problematikat e ngritura në UMT.

Në përfundim të kësaj mbledhjeje, Bordi vendosi t'i kërkojë Administratorit të UMT-së një relacion duke saktësuar gjithë procedurat e ndjekura në lidhje me:

- 1) Punësimin e personelit administrativ për znj. F. Sh; z. G. N; znj. M.J,
- 2) Përfundimin e marrëdhënies së punës me Administratorin e Fakultetit të Mjekësisë,
- 3) Hapat e ndjekur, në lidhje me punësimin e administratorit dhe magazinierit të FM-së.

Pas Relacionit të dërguar nga Administratori, Bordi i Administrimit në datën 06.12.2021 pasi shqyrtoi gjithë Relacionin dhe shkresat bashkëshoqëruese, fton në mbledhjen e kësaj date, Administratorin, për të dhënë shpjegim mbi relacionin e dërguar. Në relatin verbal z. Administrator në mbledhje, nuk paraqiti informacion shtesë apo më të detajuar nga ai i shprehur në shkresën e tij drejtuar Bordit me nr 3128/3 datë 06.12.2021.

Në përfundim të mbledhjes, Bordi kërkoi nga Drejtoria e Shërbimeve Juridike dhe e Burimeve Njerëzore një Relacion ku të shprehej qartë dhe në mënyrë shteruese vlerësimi

juridik si dhe gjithë baza ligjore e ndjekur, për të gjitha çështjet, për të cilat Bordi i Administrimit është vënë në dijeni nëpërmjet shkresave të ardhura në adresë të tij:

- 1) Procedurat e punësimeve të kryera nga Administratori i UMT-së, që në momentin e emërimit të tij si Administrator i UMT-së;
- 2) Urdhërin mbi zgjidhjen e marrëdhënieve të punës të menjëherëshme të znj. L.K. (Drejtoreshë e Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse në UMT);
- 3) Procedura e daljes në pension e znj. Zh.D. Administratore e FM-së;
- 4) Interpretimi juridik i Urdhërit të Administratorit, nr. 210, datë 06.12.2021 “Për komandimin në detyrë...”

Në datën 13.12.2021 Bordi i Administrimit shqyrtoi Relacionin e ardhur nga Drejtoria e Shërbimeve Juridike dhe e Burimeve Njerëzore dhe evidentoi qartësisht shkeljet e kryera nga Administratori i UMT-së dhe vendosi hartimin e një Relacioni “Mbi shqyrtimin e punës së Administratorit, bazuar mbi të gjithë dokumentacionin shkresor, të paraqitur në Bord”.

**Në përfundim, Bordi me kuorum, konstatoi rast pas rasti veprimet në kundërshtim me kërkesat e kuadrit ligjor sa më poshtë vijon:**

-Punësimin e personelit Administrativ të UMT-së (referuar LAL 80/2015, Statutit të UMT-së, “Urdhrat apo Udhëzimet e autoriteteve janë akte administrative individuale me anë të së cilëve autoriteti shpreh vullnetin e tij, për të ushtruar funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektsh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete”, akte për të cilat autoritetet janë përgjegjës për veprimet e tyre dhe përmbajtjes së tyre;

- Punësimi i personelit administrativ për disa pozicione pune në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, të kryera nga Administratori janë realizuar në mosrespektim të procedurave të përcaktuara nga dispozitat e cituara në Ligjin e Arsimit të Lartë dhe në mënyrë konkrete:

- Neni 57, pika 2 dhe neni 67, pika 3 e ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;

- Neni 59, pika 8 dhe neni 79 i Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë;

- Vendimi i KM nr. 176, datë 29.03.2006 “Për botimin e buletinit të njoftimeve publike”.

-Referuar përmbajtjes së Urdhrit të Administratorit nr. 184, datë 08.11.2021, vihet re se Administratori nuk ka respektuar pikën 1, 2, 3 të nënenin 144 të Kodit të Punës së RSH.

-Lidhur me arsyetimin e zgjidhjes së menjëhershme të kontratës së punës, cituar në pikën 1 (një) të Urdhrit të Administratorit të UMT nr. 184, datë 08.11.2021, Kodi i Punës së RSH, në nënenin 153 për shkaqet e cituara nga Administratori në urdhrin e tij, ligjvënësi ka caktuar gjykatën si institucioni kompetent që vlerëson shkaqet nëse janë të justifikuara apo jo (nëse çështja bëhet objekt i shqyrtimit gjyqësor). Referuar pikës 2 të nënenin 67 “Personeli administrativ” të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe pikës 1 të nënit 79, pikës 1, 2, 4, 5, 6 të nënit 80 e vijues të Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, Administratori

duhet të kishte vlerësuar situatën konkrete (realizimin e detyrave funksionale dhe gjendjen e punëmarrësit, duke marrë në konsideratë ligjërisht raportet mjekësore të paaftësisë së përkohshme në punë të dorëzuara nga punëmarrësi) të kishte respektuar afatet e njoftimit, të dëgjonte pretendimet e punëmarrësit duke mbajtur procesverbal me shkrim midis të pranishmëve dhe më pas të caktonte llojin e masës disiplinore për të.

**Ky relacion është pjesë bashkëshoqëruese e Vendimit nr. 70, datë 20.12.2021**